

Nr. Prot. 067/B/17

VENDIM Nr. 1085

Për

Shtyerjen e Afatit të Dorëzimit të Raportit të Auditimit të Sigurisë

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 3.4), nenit 10 paragrafët 4) dhe 21), nenit 85 paragrafët 1), 2), 3), 4), 5) dhe 6), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje – Ligji ose LKE*), nenit 8 të Rregullores nr. 29 mbi Standardet Teknike dhe Organizative për Sigurinë dhe Integritetin e Rrjetave dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike (*tutje – Rregullorja*), kërkesës së operatorëve IPKO Telecommunications LLC dhe Telekom i Kosovës SH.A. (*tutje referuar si – operatorët*) të datës 09/11/2017 (Ref. e-mail: Thursday, November 09, 2017 2:55 PM), dhe nenit 13 të Statutit (Ref. Nr.Prot.054/B/17) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga,

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 23 – të mbajtur më datë 24 Nëntor 2017, pas shqyrtimit të materialit të lëndës, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa e operatorëve për shtyerjen e afatit të dorëzimit të raportimit të auditimit të sigurisë sipas kërkesave të nenit 8 të Rregullores.
- II. Obligohen operatorët që deri më 01 Gusht 2018 të dorëzojnë raportin e auditimit të sigurisë.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Më datë 09 Nëntor 2017 Autoriteti ka pranuar kërkesë (Ref. e-mail: Thursday, November 09, 2017 2:55 PM) nga operatorët Telekom i Kosovës SH.A. dhe IPKO Telecommunications LLC, përmes së cilës kanë kërkuar një afat shtesë prej 6 muajsh për dorëzimin e raportit të auditimit të sigurisë.

Sipas operatorëve në fjalë, procedurat e prokurimit që duhen inicuar për përzgjedhjen e kompanisë fituese që do të bëjë auditimin e sigurisë në përputhje me kërkesat e rregullores marrin një kohë të konsiderueshme fillimisht sa i përket përgatitjeve të natyrës teknike e organizative e pastaj procesit të shqyrtimit të ofertave dhe zgjedhjes së kompanisë fituese, e cila duhet të jetë e certifikuar.

Ligji, respektivisht neni 10 (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizon se Autoriteti kryen funksionet e qendrës kopjuterike për reagime emergjente me qëllim të ballafaqimit me rreziqet për sistemet publike të komunikimeve elektronike.

Neni 85 paragrafi 6 i Ligjit përcakton se: *“Gjatë garantimit të sigurisë, integritetit dhe besueshmërisë së shërbimeve dhe rrjetave të komunikimeve elektronike publike, parandalimit të përhapjes së incidenteve të sigurisë, zoogëlimit të rrezikut për humbje nga ana e ofruesve të shërbimeve dhe/ose rrjetave të komunikimeve elektronike publike dhe/ose nga ana e shfrytëzuesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si pasojë e këtyre incidenteve, Autoriteti mund të lëshojë urdhra detyrues për ndërmarrësit që ofrojnë shërbime dhe/ose rrjeta të komunikimeve elektronike publike dhe të vendosë afate kohore për zbatimin e këtyre detyrimeve. Urdhrat detyrues që i referohen këtij paragrafi mund të përfshijnë obligimet për auditim të sigurisë që duhet të bëhet nga një organ i kualifikuar dhe i pavarur dhe që rezultatet e auditimit t’i vihen në dispozicion Autoritetit. Kostot e auditimit që i referohen këtij paragrafi duhet të barten nga ndërmarrësi.”*

Neni 8 i Rregullores përcakton se: *“operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike që rezultojnë sipas raportimeve të kryera në ARKEP me të ardhura vjetore të vitit paraardhës nga komunikimet elektronike mbi vlerën 500 000 euro duhet që të dorëzojnë pranë ARKEP raportin me rezultatet e auditimit të sigurisë, të kryer nga një organ i certifikuar dhe i pavarur ose nga autoritetit kompetet. Raporti duhet të dorëzohet periodikisht për një periudhë dy vjeçare. Kosotoja e auditimit duhet të paguhet nga ana e operatorit.”*

Duke pas parasysh atë që u tha më lart dhe faktin që Rregullorja ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2016, si dhe është hera e parë që operatorët do të bëjnë një auditim të tillë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 13/12/2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Vendimi i dërgohet:

- Telekom i Kosovës Sh.A.;
- IPKO Telecommunications LLC;
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE), ARKEP
- Departamentit Ligjor (DL), ARKEP
- KOS-CERT, ARKEP
- Arkivës së ARKEP